

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte Administrativne Poslove

D1 Nr./Br. 910/04-2857P
Data/Datum 08.11.2022
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE/A:	08.10.2022
PËR/ZA/TO:	Pjetër Qerimi, Pronar i Kompanisë “N.Sh.T.“Viktory Com”, Bec, Gjakovë
Kopje/Copy/	Arkiva e Komunës Durim Halilaj, Drejtor për Buxhete dhe Financa - Komuna Gjakovës Pjetër Marku, Menaxher i kontratës së AK Organi Mbikqyres “AL-Engineering”
PËRMES /PREKO/THROUGH	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Faton Gutaj, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për shpëputjen e kontratës me numër të prokurimit: – Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës- Kontratë dy vjeçare-Pjesa e Katërt, Lot I - Ndërtimi- Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Smaq 1 dhe Bishtazhin, me numër identifikues: 632-21-2839-5-1-1 dhe nr.brendeshëm 632-21-043-5-1-1,

I/E nderuar,

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 14.10.2021, në mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit N.Sh.T.“Viktory Com” për: “Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare-Pjesa e Katërt, Lot I - Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Smaq 1 dhe Bishtazhin, me numër identifikues: 632-21-2839-5-1-1,nr.

brendeshëm 632-21-043-5-1-1 dhe nr.protokolli 02-410/04-31098, , prej datës 09.11.2022, ndërpritet, duke u bazuar në nenin 36 dhe 37 paragrafët 37.1 dhe 37.2 nën a, të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme dhe kërkesën e dt.08.11.2022, nga Menaxheri i Kontratës për ndërprerje të kontratës .

Për mos realizimin e Punëve, konformë kushteve të kontratës, jeni të informuar disa here radhazi përmes komunikimeve zyrtare nga Menaxheri i Kontratës si dhe takimeve që keni pasur me Kryetarin e Komunës, Menaxherin e Prokurimit dhe menaxherin e kontratës .

Përkundër vërejtjeve të shumta Ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të kualitetit dhe dinamikës për realizimin e punimeve. Sipas informatave dhe dëshmimeve që kemi pranuar nga Menaxheri i Kontratës edhe pse ju është rekomanduar që të vazhdoni punimet, ju për vitin fiskal 2022, nuk keni punuar fare me çka është dëshmuar se nuk i keni përmbush obligimet edhe pse kushte kanë qenë të favorshme për realizimin e punimeve.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar këtë aktivitet të prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 09.11.2022 do të ndërmarrim të gjitha veprimet konforme kushteve të kontratës - neni 36, paragrafi 36.4 dhe neni 37, paragrafi 37.5 i kontratës.

Shkresës i bashkëngjitet kërkesa e Menaxherit të kontratës për ndërprerje të kontratës.

Me respekt.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	08.11.2022
REFERENC - E:	
PER/ZA/TO:	Zyrën Prokurimit, - z. Faton Gutaj
NGA/OD/FROM:	Menaxheri i Kontratës – Pjeter Marku
CC:	Drejtoria për Shërbime Publike – z. Shkumbin Kastrati Kryetari i Komunës – z. Ardian Gjini Operatori për Mbikëqyrje të Projekteve – AL Engjëllini shpk
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi për Ndërprerjen e Kontratës me titull: "Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne fshatrat Smaq 1 dhe Bishtazhin " me nr. identifikues: 632-21-23-5-1-1

Duke u bazuar në pikën 61.27 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në ecurinë e punimeve të kësaj kontrate po ju parashtroj këtë rekomandim për ndërprerje të kontratës me titull: "Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne fshatrat Smaq 1 dhe Bishtazhin " me nr. identifikues: 632-21-23-5-1-1 **e lidhur me datë 14.10.2021 ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe operatorit, NSHT "VIKTORY COM"**.

Arsyetimi:

- Kontrata është nënshkruar ne **14.10.2021**, pas përfundimit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit për projektin në fjalë, pas buxhetimit dhe me fillimin e punimeve iu është dhënë urdhëresë për fillim të punimeve operatorit me datë: **19.10.2021**.
- Pas shumë takimeve në mes të Kryetarit të Komunës, Menagjerit të Zyres së Prokurimit dhe Operatorit Ekonomik, Operatori Ekonomik për vitin fiskal 2022 nuk ka punuar fare.

Duke u bazuar nga ajo që u tha më lart ju rekomandoj që kjo kontratë të ndërpritet duke vepruar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Me Respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Postal address: Nëna Terezë, Nr. 469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>